



Rr. Haxhi Kika(Kompleksi :Kika i RI) Nd.9, Hyrja 3, Ap.28
Njesia Administrative Nr.5/1022
TIRANE, ALBANIA

Phone 00355 66 40 55 663
E-mail : ave_consulting@yahoo.com

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

“PARKIMI NËNTOKËSOR TE SHESHI ITALIA”

INVESTITOR: "BASHKIA TIRANË"

SHESHI NDËRTIMIT: TIRANË



PËRMBAJTJA

A.Punime Arkitektonike

B.Punime Konstruksioni

C.Punime Hidrotekinike

D.Punime Elektrike

E.Punime MNZSH



PËRGATITI

A.Punime Arkitektonike

Ark.Daniel Gjoni

Ark.Giovanni Polazzi

Ark.Marco Casamonti

B.Punime Konstruksioni

Ing.Arben Dervishaj

Ing.Ervin Paçi

C.Punime Hidrotekinike

Ing.Alket Kumaraku

D.Punime Elektrike

Ing.Selajdin Ago

E.Punime MNZSH

Ing.Artan Dersha



A.Punime Arkitektonike

1.Të përgjithshme

Projekti përfshin ndërtimin e një vend parkim nëntokë për makinat më poshtë Sheshit Italia në Tiranë. Ndërtesa përbëhet nga dy kate nëntokësore: L-1 bëhet e arritshme nga rruga aktuale nëpërmjet një rampe të përbashkët me kompleksin e Stadiumin kombëtar të Ri, që është akoma në ndërtim. Niveli i L-2 mund të arrihet me anë të një rampe të brendshëm në parking.

2.Informacione të përgjithshme

Sipërfaqja:

L-1: 3,587 m².

L-2: 3,587 m².

Lartësia neto e kateve:

L-1: 3.20 m

L-2: 2.56 m

Vende parkimi:

L-1: 92

L-2: 104

Hapësira parkimi për njerëzit me aftësi të kufizuara:

2 (të vendosur në nivel L-1)

lidhjeve vertikale:

2 Shkallë (Gjatësia e rampës = 1.20 m)

n. 1 Ashensor (kapaciteti 13 persona - shpejtësi 1.6 m / s)

3.Pershkrimi i projektit

Parkingu është i përbërë nga 5 kampata strukturore të alternuara me madhësi të ndryshueshme të tilla për të krijuar një korsi unazore me një sens lëvizje në lidhje me dy rreshtat qendror të vendqëndrimit të automjeteve. Në hyrje të tij parkimi kufizohet nga një derë rrëshqitje me dy dyer në lartësi të plotë. Një vendroje qendrore ndan korsin e hyrjes nga ajo e daljes dhe lejon kontrollin e hyrje-daljeve.

Një rampe me dy sense të lëvizjes dhe plan gjysmërrethore është vendosur në veri të ndërtesës dhe lejon arritjen e nivelit të dytë të parkimit. Nga niveli L-2 ngjitja është e garantuar nga e njëjta rampë dhe në këtë kat qarkullimi është i ngjashëm me atë të katit të mësipërm.

Përgjatë mureve gjatësore për të dy katet është krijuar një zgavër nëntokësore që përmes sistemeve të mureve dhe gojës së ujkut largohet ajri i ndotur i garazhit dhe lejon ventilim natyror. Këto hapësira janë të mbuluara në nivelin e sheshit me grila çeliku.

Dy sistemet e lëvizjes në lartësi janë të vendosur në dy anët e parkimit. Një nga dy blloqet gjithashtu përmban një ashensor me kapacitet prej 13 njerëzve dhe shpejtësinë 1.6 m / s.

Ky bllok është e mbuluar në nivel të sheshit nga një strehë me strukture metalike me kapriata të veshura me Korten .

Muret e garazh dhe dyshemetë janë bërë me beton facciavista. Struktura është konceptuar me soleta të mbështetur në kollona. Kjo karakteristikë, së bashku me përfshirjen e elementëve ndriçues dhe pajisjeve të sigurisë garantojnë planet e përsosur e intradosit të pllakave të dyshemesë.

Të gjitha pajisjet e sigurisë dhe shërbimit do të jenë inkaso në muret beton arme të strukturës .



B.Punime Konstruksioni

PËRMBAJTJA

1. KODET DHE REFERENCAT
2. MATERIALET
BETONI
ARMATURA HEKURIT
STRUKTURA METALIKE
3. NGARKESAT LLOGARITËSE NË PROJEKT
 - 3.1 NGARKESA TË PËRHERSHME
 - 3.2 NGARKESA TË PËRKOSSHME
 - 3.3 NGARKESAT SIZMIKE
4. KRITERET E PROJEKTIMIT
KOMBINIMI I NGARKESAVE
EFEKTI I PËRDREDHJES AKSIDENTALE
FAKTORI I RËNDËSISË SIPAS KATEGORIZIMIT
SPOSTIM I NDËRKATIT(DRIFTI)
SPEKTRI I SJELLJES ELASTIKE
SPEKTRI LLOGARITËS
5. ANALIZA STATIKE DHE DINAMIKE
 - 5.1 PËRSHKRIMI I STRUKTURËS
 - 5.2 NUMËRIMI I PIKAVE BAZË
 - 5.3 PËRSHKRIMI I ANALIZËS SIZMIKE
 - 5.3.1 MODELI STRUKTUROR I DIXHITALIZUAR
 - 5.3.2 MODELI I NGARKESAVE I DIXHITALIZUAR
 - 5.3.3 MODELI I SJELLJES SIZMIKE I DIXHITALIZUAR
 - 5.4 ANALIZA SIZMIKE E GODINËS (SIPAS EUROKOD 8)
 - 5.4.1 FORMAT MODALE MË TË RËNDËSISHME
 - 5.4.2 PERIODA E VIBRIMIT ,MASAT EFEKTIVE DHE FORCAT VEPRUESE NË BAZË
6. LLOGARITJET E ELEMENTËVE STRUKTURALE
 - 6.1 TË DHËNAT
 - 6.2 TË DHËNAT NGA SIZMIKA
 - 6.3 KONTROLLET
 - 6.3.1 SOLETAT
 - 6.3.2 TRARËT
 - 6.3.3 KOLLONAT
 - 6.3.4 MURET

1.KODET DHE REFERENCAT

Analiza strukturale për këtë objekt është bërë në përputhje me EUROKODET si vijon.

Eurokod 1. Ngarkesat që veprojnë në ndërtesa
Eurokod 8. Projektimi i ndërtesave rezistente ndaj tërmeteve
Eurokod 3 Projektimi i strukturave metalike, ENV 1993.
Eurokod 2 Projektimi i strukturave b/arme, ENV 1992.
Eurokod 7 Projektimi i themeleve

Gjithashtu llogaritjet dhe konstruimet i janë referuar edhe kushteve shqiptare të projektimit.

2. MATERIALI

Në përputhje me Eurokodet llogaritjet janë bërë në SLU e një projekti janë bërë

Materialet e përdorura dhe sforcimet llogaritëse janë:

2.1 *Betoni*

Betoni- Klasa C35/45 për skeletin b/a ,soletat dhe elementet sekondarë të strukturës (arkitarrë, breza etj.) dhe C30/37 për themelet.

-Për të gjitha strukturat prej betoni C35/45

Pesha vetjake

$$\gamma = 2500 \text{ kg/m}^3$$

Rezistenca në shtypje prizmatike e betonit

$$f_{ck} = 350 \text{ (300) daN/cm}^2 \quad \text{C35/40}$$

Moduli i elasticitetit

$$E_c = 340770 \text{ daN/cm}^2$$

Rezistenca llogaritëse për betonet janë:

$$f_{cd} = 267 \text{ daN/cm}^2$$

$$f_{ctm} = 32 \text{ daN/cm}^2$$

$$f_{ctk 0.05} = 22 \text{ daN/cm}^2$$

Ku

$$f_{ctm} = 0.3 \times f_{ctk}^{(2/3)}$$

$$f_{ctk\ 0.05} = 0.7 \times f_{ctm}$$

Koeficienti i Puasonit(beton me çarje)

$$\nu = 0.1$$

Koefiçenti i sigurisë së pjesshme

$$\gamma_c = 1.5$$

2.2 Armatura

Shufrat e hekurit të llojit B-500c kanë karakteristikat e mëposhtme

Rezistenca në tërheqje

$$f_{tk} = 6280 \text{ daN/cm}^2$$

Sforcimet e pragut të rrjedhshmërisë

$$f_{yk} = 5000 \text{ daN/cm}^2$$

Moduli i elasticitetit

$$E_c = 2100000 \text{ daN/cm}^2$$

Koeficienti i zgjatjes relative > 12%

$$A_5 = 12\%$$

$$(f_t / f_y)_k = 1.256$$

Koefiçenti i sigurisë së pjesshme

$$\gamma_s = 1.15$$

Rezistenca e lejuar

$$f_{yd} = 3700 \text{ daN/cm}^2$$



3. NGARKESAT LLOGARITËSE

Ngarkesat në vijim janë përdorur në këtë projekt

3.1 Ngarkesat e përhershme

Ngarkesa e përhershme e përdorur në këtë strukturë përbëhet nga disa komponentë:

- Pesha vetiake e elementëve
- Muret ndarës
- Ngarkesë e përhershme mbi soletë

Këto ngarkesa janë llogaritur dhe marrë në bazë të kodeve të permendura më sipër.

Pesha vetjake e soletës dhe mureve janë llogaritur më poshtë.

Për soletën e mbulesës së parkimit kemi prezent edhe një ngarkesë të përhershme e shkaktuar nga dheu që mbulon soletën. Kjo ngarkesë është konsideruar 11 kPa. Ndërsa për soletën L-01 kjo mbingarkesë është konsideruar 4kPa.

Soletë nderkati H=30(40)cm

- Soletë në b/arme monolite 750(1125) Kg/m²
- Shtresa dhe pllaka $\frac{250 \text{ Kg/m}^2}{920 \text{ Kg/m}^2}$

3.1(1) Ngarkesa vertikale lineare e mureve

Mur 25cm (tulla me bira horizontale)	1250 Kg/ml
Mur 12cm (tulla me bira horizontale)	650 Kg/ml
Parapete b/arme	300 Kg/ml
Mbyllje me vetratë	300 Kg/ml

3.2 Ngarkesa të përkohshme

Në përputhje me Ec1 ngarkesat e përkohshme të përdorura në këtë projekt kanë vlerat e mëposhtme

Rezidenca	(Ec1-Cat A)	200	Kg/m ²
Dhoma hoteli	(Ec1-Cat A)	200	Kg/m ²
Mbulimi (terrace)	(Ec1-Cat I)	200	Kg/m ²
Zyra	(Ec1-Cat B)	300	Kg/m ²
Restorant	(Ec1-Cat C1)	300	Kg/m ²
Salla konferencash, Kinema	(Ec1-Cat C2)	400	Kg/m ²
Holle hoteli ,Ekspozita	(Ec1-Cat C3)	500	Kg/m ²
Palestra	(Ec1-Cat C4)	500	Kg/m ²
Dyqane	(Ec1-Cat D)	500	Kg/m ²
Magazina	(Ec1-Cat E)	600	Kg/m ²
Shkallë	(Ec1-Cat E)	400	Kg/m ²


Duke konsideruar kushtet dhe funksionet e shërbimit të kësaj strukture, ngarkesat e përkohshme të marra në konsideratë për llogaritjen, janë:

<u>Soletat e L 0</u>	<u>H=40 cm</u>	600 Kg/m ²
<u>Soletat e L-1</u>	<u>H=30 cm</u>	300 Kg/m ²
<u>Soletë e shkallës</u>	<u>H=25 cm</u>	500 Kg/m ²

3.3 Ngarkesat sizmike

KOEFICIENTËT SIZMIK NË PROJEKT

Për analizën e kësaj strukture është marrë në konsideratë edhe efekti nga veprimi sizmik i zonës. Ky efekt është konsideruar në përputhje me karakteristikat e strukturave nëntokësore. Për një strukturë të tillë, efekti dhe zhvendosja që pëson struktura është më i vogël se një strukturë mbitokësore. Kjo diferencë rezulton si rrjedhojë e reaksionit të dheut rrethues, karakteristikë kjo e strukturave nëntokësore. Ky reaksion i dheut është modeluar në program, në formën e sustave elastike, për muret rrethuese. Koeficienti që merr në konsideratë këtë efekt është llogaritur dhe rezulton 230000 kN/m³.



Modelimi i sustës në strukturë

Si rezultat i prezencës së dheut rrethues në strukturat nëntokësore, sizmika e zonës do të shkaktoje një zhvendosje të strukturës, të moderuar. Ky zvogëlim i zhvendosjes të drejtpërdrejte që i shkaktohet strukturës, në krahasim me një strukturë mbitokësore, vjen si rrjedhojë e zhvendosjes translative që pëson e gjithë struktura së bashku me dheun rrethues. Kjo zhvendosje translative, i zbritet efektit sizmik, dhe efekti i drejtpërdrejte në strukturë, i forcës sizmike rezulton të jetë në një masë më të vogël për strukturat nëntokësore.

Karakteristikat sizmike të zonës ku do të ndërtohet janë si më poshtë:

Ngarkesa vepruese horizontale në truall te tipit A	a_g	0,27
faktori i kategorizimit të tokës sipas llojit	(lloji C) S	1,25
Koeficienti i sjelljes së objektit sipas kategorizimit	(Ramë hapsinore) q_0	3.0
Koeficienti sipas shkallës së duktilitetit	(DCM, Mesatare) K_d	1,0
Koeficienti sipas rregullsisë së objektit në lartësi	(i rregullt) K_r	1,0
Koeficienti sipas shkallës së shkatërimit të objektit	α_u/α_1	1,3
Koeficienti i sjelljes së strukturës	$q_0 \times K_d \times K_r \times \alpha_u/\alpha_1$	3.90

4. KRITERET E PROJEKTIMIT

4.1 Kombinimi i ngarkesave

Struktura është kontrolluar për gjendjen kufitare (SLU), gjendjen e lejuar të funksionalitetit (SLS) dhe për gjendjen e lejuar të deformimit(shkatërimit) (SLD)

Ngarkesat janë kombinuar siç janë treguar dhe më poshtë, ku IE është veprimi sizmik për gjendjen e lejuar nën egzaminim, G_t është vlera karakteristike e veprimit të përkohshëm, Q_{1k} vlera karakteristike e veprimit variabël të situatës së krijuar prej ngarkesave, Q_{ik} është vlera karakteristike e situatës variable i; γ_g , γ_p and γ_q janë faktorë të sigurisë pjesore, ψ_{0i} është koeficient kombinimi i cili jep 95% të vlerës së aksionit variabël i, ψ_{2i} është koeficienti i kombinimit i cili jep vlerën e përafërt të veprimit të përkohshëm variable i.

Situata në projekt	Kombinimi i ngarkesave
SLU	
I përhershëm	$\gamma_g G_k + \gamma_q [Q_{1k} + \sum_i(\psi_{0i} Q_{ik})]$
Sizmik	$IE + G_k + \sum_i(\psi_{2i} Q_{ik})$

SLS

Rrallë

$$G_k + Q_{1k} + \sum_i(\psi_{0i} Q_{ik})$$

Frekuent

$$G_k + \psi_{11} Q_{1k} + \sum_i(\psi_{2i} Q_{ik})$$

Gati permanent

$$G_k + \sum_i(\psi_{2i} Q_{ik})$$

SLD

Sizmik

$$IE + G_k + \sum_i(\Psi_{0i} Q_{ik})$$

Vlerat e koeficientëve të kombinimit janë marë në konsideratë si më poshtë :

$$\gamma_g = 1.35 \quad (\text{ose } 1 \text{ nëse kontributi i tij jep më shumë siguri})$$

$$\gamma_q = 1.5 \quad (\text{ose } 1 \text{ nëse kontributi i tij jep më shumë siguri})$$

$$\psi_{0i} = 0.7$$

$$\psi_{1i} = 0.6$$

$$\psi_{2i} = 0.3 / 0.6 / 0.8$$

Veprimi sizmik është marë në konsideratë me dy komponentët e saj ortogonale , të cilësuar IE_x dhe IE_y ; ku të dy veprimet respektive të komponenteve përfaqësojnë të njëjtën spëktër reagimi dhe plotesojnë kombinimin kuadratik (CQC), metodë e cila është përdorur si kombinim i të dyjave përbërësve.

Dy kombinimet e mundshme janë si vijon

$$\begin{array}{ccc} IE_x & "+" & 0,3*IE_y \\ 0,3*IE_x & "+" & IE_y \end{array}$$

Ku shenja “+” ka kuptimin “të kombinohet me “

IE_x janë efektet e forcave në sajë të veprimit të aksionit sizmik përgjatë aksit të zgjedhur horizontal x në strukturë

IE_y janë efektet e forcave në sajë të veprimit të të njëjtit veprim sizmik përgjatë aksit të zgjedhur ortogonal y në strukturë

Efektet inerciale të ngarkesave sizmike të hedhura do të vlerësohen duke marë parasysh dhe masat e lidhura dhe me të gjitha ngarkesat e gravitetit që shfaqen në kombinimin që vijon .

$$G_k + \sum_i(\psi_{Ei} Q_{ik})$$

Ku koeficienti i kombinimit ψ_E mer parasysh propabilitetin e ngarkesave $\psi_{Ei} Q_{ik}$ që nuk mund të jenë prezentë përgjatë gjithë stukturës në momentin e veprimit të ngarkesës sizmike.

Coefficienti ψ per gli edifici

Azione	ψ_0	ψ_1	ψ_2
Sovraccarichi sugli edifici ¹⁾ :			
categoria A: domestici e residenziali	0,7	0,5	0,3
categoria B: uffici	0,7	0,5	0,3
categoria C: aree di congresso	0,7	0,7	0,6
categoria D: aree di acquisto	0,7	0,7	0,6
categoria E: magazzini	1,0	0,9	0,8
Carichi del traffico negli edifici:			
categoria F: peso del veicolo ≤ 30 kN	0,7	0,7	0,6
categoria G: 30 kN < peso del veicolo ≤ 160 kN	0,7	0,5	0,3
categoria H: tetti	0,0	0,0	0,0
Carichi da neve sugli edifici	0,6 ²⁾	0,2 ²⁾	0,0 ²⁾
Carichi da vento sugli edifici	0,6 ²⁾	0,5 ²⁾	0,0 ²⁾

Vlera minimale e kombinimit të koeficientit ψ_{Ei} të prezantuar për të llogaritur efektin e veprimt sizmik do të jetë i kategorizuar sipas shprehjeve të mëposhtme

Valori del coefficiente ϕ per il calcolo degli ψ_{Ei}

Tipo di azione variabile	Impiego dei piani		ϕ
Categorie A-C*	piani impiegati indipendentemente	piano superiore	1,0
		altri piani	0,5
Categorie A-C*	alcuni piani con impieghi correlati	piano superiore	1,0
		piani con impieghi correlati	0,8
		altri piani	0,5
Categorie D-E* Archivi			1,0

Rezidencat (Ec1-Cat A) $\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,3 \times 0,5 = 0,15$

Mbulimi (Ec1-Cat I) $\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,3 \times 1,0 = 0,30$

Zyra (Ec1-Cat B) $\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,3 \times 0,5 = 0,15$

Restorante (Ec1-Cat C1) $\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,6 \times 0,8 = 0,48$

Holl hoteli ,ekspozita (Ec1-Cat C3) $\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,6 \times 0,8 = 0,48$

Palestra	(Ec1-Cat C4)	$\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,6 \times 0,8 = 0,48$
Dyqane	(Ec1-Cat D)	$\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,6 \times 0,8 = 0,48$
Magazina	(Ec1-Cat E)	$\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,8 \times 1,0 = 0,80$
Shkallë	(Ec1-Cat E)	$\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,8 \times 1,0 = 0,80$
Parkime	(Ec1-Cat F1)	$\psi_{Ei} = \psi_{2i} \times \phi = 0,6 \times 1,0 = 0,60$

4.2 Efektet aksidentale në përdredhje

Në mënyrë që të mbulohen paqartësitë në pozicionimin e masës dhe në nocionin e variacionit hapsinor sizmik, qendra e masës në llogaritjet në secilin nga katet do të konsiderohet e zhvendosur nga çdo qendër e vet e nominuar dhe e lokalizuar sipas çdo drejtimi me një jashtëqendërsi aksidentale:

$$e_{ai} = \pm 0.05 L_i$$

ku e_{ai} jashtëqendërsia aksidentale e masave në kate
 L_i përmasa e godinës perpendikular me drejtimin e veprimit sizmik.

Nëse shtangësia laterale dhe masa janë të shpërndara në plan mjaftueshmerisht simetrike, efekti aksidental i përdredhjes mund të llogaritet ose të kihet parasysh duke shumëfishuar efektin e veprimit të çdo ngarkese individuale në çdo element me një faktor δ të dhënë nga:

$$\delta = 1 + 0,6 \cdot \frac{x}{L_e}$$

Ku:

x është distanca nga elementi i marrë në konsideratë (nga qendra e masës së ndërtesës në plan të matur perpendikular me drejtimin e aksionit sizmik të marrë në konsideratë).

L_e është distanca ndërmjet dy elementëve më të largët të ngarkuar, e matur perpendikular me drejtimin e veprimit sizmik të marrë në konsideratë.

Për rastin tonë kemi $e_{ax} = \pm 5,3m$ në drejtim x

Për rastin tonë kemi $e_{ay} = \pm 1,84m$ në drejtim y

4.3 Faktori i rëndësisë sipas ndërtesave.

Ndërtesat janë kategorizuar në klasa të ndryshme sipas rëndësisë, duke u nisur nga konsekuencat e një kolapsi për jetën njerëzore dhe për rëndësinë e tyre në sigurinë publike dhe civile, mbrojtja e menjëhershme përgjatë një lëkundje sizmike, si dhe pasojat sociale dhe ekonomike të një kolapsi .

Klasat e rëndësisë të një objekti janë të karakterizuar nga një sërë faktorësh të ndryshëm γ_i të cilat janë të lidhura me pasojat dhe dështimet e një strukture.

Faktori i rëndësisë $\gamma_i = 1,0$ është marrë në konsideratë për llogaritjen e objektit .

4.4. Spostimi i nderkatit

“Kërkesat mbi dëmin e limituar” është quajtur e pranueshme nëse gjatë një veprimi sizmik me një probabilitet më të madh se veprimi sizmik respektiv që i korrespondon kërkesës së jokolapsit, spostimi i katit të jetë i limituar.

Për strukturat që kanë elemente jostrukturale me elemente të dobët të bashkangjitur me strukturën: $d_r < 0,005 h$

ku: d_r spostimi i ndërkatit referuar kjo limitit të mundshëm të gjendjes së dëmtimit h lartësi ndërkatit.

Për rastin tonë drifitet janë të pa konsiderueshme


5. ANALIZA STATIKE DHE DINAMIKE

5.1 Përshkrimi i strukturës

Objekti në vetvete, për shkak të formës gjeometrike në plan ashtu edhe në lartësi ka një simetri njëaksiale. Struktura është konceptuar si një sistem ramash ortogonale. Rama hapsinore thith si forcat vertikale ashtu edhe ato horizontale. Sistemi është konsideruar si sistem me nyje të spostueshme.

Themeli i objektit është konceptuar të realizohet me pllakë b/a. Pllaka do të mbështetet mbi një shtresë betoni të varfër 10cm.


Struktura do të realizohet me soleta monolite për të dy katet. Trashësia e soletës për “katin 0” është 40cm dhe për “katin -1” është 30cm. Ky dimensionim është bërë në funksion të hapësirave dhe ngarkesave që duhet të përballojë çdo soletë. E gjithë soleta është e organizuar me një rrjetë trarësh të brendshëm ortogonale, të cilët ndihmojnë në shpërndarjen më të mirë të ngarkesave. Kollonat do të jenë rrethore me diametër 60cm. Dimensionet e elementëve konstruktive janë në përputhje me rekomandimet e EC8. Muret b/arme perimetrale të treguar në planet konstruktive janë 40 cm. Në perimetër të objektit, është realizuar një perde pilotash të treguara në planin përkatës.




Imazhe 3D të modelit llogaritës të strukturës

5.3 Përshkrimi i analizës

Për shkak të formës së strukturës është zgjedhur modeli 3D nën ngarkesa vertikale dhe një veprimi sizmik të moderuar, duke qenë se është një ndërtesë e realizuar krejtësisht nën tokë. Modeli i realizuar në programet llogaritës jepet më poshtë:



Soleta L-01



Soleta L-0

Nga rezultatet e marra nga analiza, struktura i plotëson kushtet teknike të projektimit.

Zhvendosja max e vërejtur është $U_x = 0.8$ cm. Kjo zhvendosje është brenda normave të projektimit.

- Cases: 1 2 4to8

	UX (cm)	UY (cm)	UZ (cm)	RX (Rad)	RY (Rad)	RZ (Rad)
MAX	0,5	0,8	0,1	0,002	0,002	0,002
Node	2568	8310	2572	5996	1436	602
Case	5 (C) (CQC)	5 (C) (CQC)	8	6 (C)	6 (C)	5 (C) (CQC)
Mode			CQC			
MIN	-0,0	-0,0	-1,1	-0,002	-0,003	-0,000
Node	9786	8130	10712	6001	7345	602
Case	6 (C)	6 (C)	6 (C)	6 (C)	6 (C)	6 (C)
Mode						

Sjellja modale dhe perioda e strukturës janë dhënë në tabelat në vijim:

- Cases: 3 7 8

Case/Mode	Frequency (Hz)	Period (sec)	Rel.mas.UX (%)	Rel.mas.UY (%)	Rel.mas.UZ (%)	Cur.mas.UX (%)	Cur.mas.UY (%)	Cur.mas.UZ (%)	Total mass UX (kg)	Total mass UY (kg)	Total mass UZ (kg)
3/ 1	3,99	0,25	6,42	58,47	0,0	6,42	58,47	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 2	5,49	0,18	66,53	68,61	0,0	60,10	10,13	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 3	6,38	0,16	68,16	69,77	0,0	1,64	1,16	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 4	7,45	0,13	68,17	69,77	0,0	0,01	0,00	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 5	8,50	0,12	68,27	69,78	0,0	0,09	0,01	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 6	8,70	0,12	76,36	71,09	0,0	8,09	1,31	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 7	8,80	0,11	80,79	71,32	0,0	4,44	0,23	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 8	9,33	0,11	80,85	77,13	0,0	0,06	5,81	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 9	10,18	0,10	80,89	77,79	0,0	0,04	0,66	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
3/ 10	10,39	0,10	81,03	78,33	0,0	0,14	0,54	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 1	3,99	0,25	6,42	58,47	0,0	6,42	58,47	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 2	5,49	0,18	66,53	68,61	0,0	60,10	10,13	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 3	6,38	0,16	68,16	69,77	0,0	1,64	1,16	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 4	7,45	0,13	68,17	69,77	0,0	0,01	0,00	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 5	8,50	0,12	68,27	69,78	0,0	0,09	0,01	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 6	8,70	0,12	76,36	71,09	0,0	8,09	1,31	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 7	8,80	0,11	80,79	71,32	0,0	4,44	0,23	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0
7/ 8	9,33	0,11	80,85	77,13	0,0	0,06	5,81	0,0	23708357,8	23708357,8	0,0

Driftet e kateve të strukturës:


Case/Story	UX (cm)	UY (cm)	dr UX (cm)	dr UY (cm)	d UX	d UY	Max UX (cm)	Max UY (cm)	Min UX (cm)	Min UY (cm)
4 (C) (CQC)	0,1	0,1	0,1	0,1	0,00	0,00	0,2	0,2	0,0	0,0
4 (C) (CQC)	0,3	0,3	0,2	0,1	0,00	0,00	0,4	0,7	0,0	0,0
5 (C) (CQC)	0,1	0,2	0,1	0,2	0,00	0,00	0,2	0,3	0,0	0,0
5 (C) (CQC)	0,3	0,5	0,2	0,3	0,00	0,00	0,5	0,8	0,0	0,0
6 (C)/ 1	-0,0	-0,0	-0,0	-0,0	-0,00	-0,00	0,0	0,0	-0,0	-0,0
6 (C)/ 2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,00	0,00	0,0	0,0	-0,0	-0,0

6. KONSTRUIMET E ELEMENTËVE STRUKTURAL


Llogaritjet e elementëve strukturalë janë bërë sipas Eurocode 2 duke patur parasysh hierarkinë e rezistencave dhe kushtet konstruktive që struktura të mund të disponoje energji sipas shkallës së duktilitetit të zgjedhur. Kujdes i veçantë është treguar për armimin e zonave kritike të kollonave dhe detajit të lidhjes së kollonës me soletën. Në to janë llogaritur me kujdes koeficientat e shtyrëngimit si dhe kontrollat e soletës në shpim. Për shkak të zgjedhjes së soletës krejtësisht pa

trarë, vëmendje e veçantë i është kushtuar armimit të nyjeve të mbështetjes së soletës mbi kollonë, duke plotësuar nevojën e konstruimit si nga momenti dhe nga forca prerëse. Për të gjithë elementët janë zbatuar të gjitha kërkesat e Eurokodit.


Plani i themeleve





Armim kollone



Soleta e katit 0




Soleta e katit -1




Armim traut


- Rezultatet e marra nga analiza e objektit




Epjura M_x-x për L-1




Epjura M_y-y per L-1




Epjura Mx-x per L0



Epjura My-y per L0



Epjurat e forcave të brendshme për një kollonë anësore dhe një kollonë mesi, respektivisht.



Epjurë momentesh për trarët

C.Punime Hidroteknike

1. TË PËRGJITHSHME

Sistemi i kullimit të ujërave të reshjeve atmosferike mbi parkingun (në sheshin "Italia") dhe të ujërave të bardha apo pjesërisht të ndotura të parkimit, përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- Kanalet prej betoni të polimerizuar në pjesën e sipërme dhe të poshtme të rampave dhe në sheshin mbi parkingun. Këto kanale do të jenë me pjerrësi të brendshme dhe do të montohen me copa me gjatësi 0.50 m dhe 1 m, sipas skemës së dhënë. Këto kanale do të mbulohen me kapak zgarë prej gize sferoidale (GS) me gjatësi $L = 1000$ mm dhe gjerësi $b = 200$ mm (kanali ka gjerësi $b = 235$ mm dhe thellësi të ndryshueshme nga $h = 265$ mm deri në 365 mm). Gjatësitë e kanaleve të shehsit jepen në vizatime.
- Piletat prej gize sferoidale të vendosura në soletën e ndërkatit midis dy kateve të parkimit (katit – 1 dhe katit -2). Këto pileta janë me kapak zgarë GS me formë katrore $b \times L = 300 \times 300$ mm dhe me dalje vertikale DN 100 mm, të cilat e shkarkojnë ujin në linjat e largimit të ujit prej GS nën soletën e ndërkatit (tavanin e katit -2).
- Pusetat ujëkapëse në pllakën e themelit, me kapak tip zgarë prej GS me formë katrore $b \times H = 400 \times 400$ mm. Këto puseta e përcjellin ujin tek linjat e largimit me tubacione polietileni brenda pllakës B/A të themelit.
- Tubacionet prej GS të montuara nën tavanin e katit më të poshtëm të parkimit (katit -2). Këto tubacione lidhen me gota dhe gomina dhe janë trasuar të montohen me pjerrësi minimale $p = 0.005$ m/m. Lidhjet e piletave me këto tubacione bëhet me braga dhe me bërryla prej GS me kënd 45° . Këto tubacione e përcjellin ujin tek dhoma teknike e largimit të ujërave të parkingut.
- Tubacionet prej polietileni të dendësisë së lartë, me dy shtresa (shtresa e jashtme e brinjuar dhe shtresa e brendshme e lëmuar), e kategorisë SN8. Këto linja do të montohen brenda pllakës së themelit, me pjerrësi $p = 0.005$ m/m, duke e përcjellë ujin tek dhoma teknike e largimit të ujërave të parkingut.
- Tubacionet prej polietileni të dendësisë së lartë, me dy shtresa (shtresa e jashtme e brinjuar dhe shtresa e brendshme e lëmuar), e kategorisë SN8 të parashikuara të montohen në sheshin sipër parkingut për largimin e ujërave të reshjeve atmosferike nga kanalet dhe pusetat e kapjes së ujit. Këto linja e përcjellin ujin tek pusetat e lidhjes me rrjetin rrugor të SKURA. Këto linja do të montohen në shtresat e mbushjes së sheshit,

pjesërisht mbi soletën e parkingut dhe pjesërisht në terrenin natyral përreth parkingut, me pjerrësi $p = 0.005$ m/m.

- Pusetat shimbledhëse prej B/A të vendosura në sheshin mbi parkimin. Këto puseta, përveç kapjes së ujit nga sipërfaqja e sheshit, do të shërbejnë edhe si puseta bashkimi dhe kontrolli të tubacioneve nga kanalet apo pusetat paraardhëse. Këto puseta do të jenë me kapak GS me formë katërkëndore me përmasa 70 x 40 cm.
- Pusetat e kontrollit apo të lidhjes së kanaleve me tubacionet. Këto puseta do të jenë prej B/A, me seksion 50 x 50 cm, me thellësi $H = 50$ cm, me kapak B/A.

Dhoma teknike e sistemit të largimit të ujërave

Kjo dhomë do të ketë pajisjet e mëposhtme të cilat shërbejnë për trajtimin dhe largimin e ujërave. Pajisjet janë si më poshtë:

- Njësitë e ngritjes mekanike të ujërave, të cilat do të shërbejnë për ngritjen e ujit nga katet e parkingut, në pusetën e sistemit të kullimit të sheshit mbi parking. Janë parashikuar 2 njësi, si pasojë e mungesës së hapësirë, për vendosjen e një stacioni të mirëfilltë me ngritje mekanike. Parametrat e njësisë janë $q = 20$ l/sek = 72 m³/orë, $H = 15$ ÷ 20 m.
- Rërëmbledhësi, i cili do të jetë një depozitë e parafabrikuar dhe që shërben për kapjen e rërërave, me qëllim ruajtjen dhe mosdëmtimin e pompave dhe tubacioneve të dërgimit pas pompave. Karakteristikat e tij do të jepen tek specifikimet teknike. Parametrat hidraulikë do të jenë të njëjtë me parametrat e njësisë së pompimit.
- Ndarësi i vajrave, i cili do të jetë një depozitë e parafabrikuar dhe që shërben për ndarjen e vajrave të mundshme që shpohen nga parking, me qëllim ruajtjen dhe mosdëmtimin e pompave dhe tubacioneve të dërgimit pas pompave, por edhe të mjedisit ku ato shkarkohen. Karakteristikat e tij do të jepen tek specifikimet teknike. Parametrat hidraulikë do të jenë të njëjtë me parametrat e njësisë së pompimit.

2. Projektimi

2.1. STANDARDET E PROJEKTIMIT TË SISTEMIT

Sistemi i kullimit të ujërave të parkingut është projektuar sipas metodave, formulave dhe tabelave të përcaktuara në standardet teknike europiane si më poshtë:

- EN 752 Drain and sewer systems outside buildings:
- Part 1: Generalities and definitions
 - Part 2: Performance requirements
 - Part 3: Planning

- Part 4: Hydraulic design and environmental considerations
- Part 6: Pumping installations

EN 12056 Gravity drainage systems inside buildings

- Part 1: General and performance requirements
- Part 2: Sanitary pipework, layout and calculation
- Part 3: Roof drainage, layout and calculation
- Part 4: Wastewater lifting plants – Layout and calculation

EN 12050 Wastewater lifting plants for buildings and sites. Principles of construction and testing

- Part 2: Lifting plants for faecal-free wastewater
- Part 4: Non-return valves for faecal-free wastewater and wastewater containing faecal matter

2.2. LLOGARITJET HIDRAULIKE

2.2.1. LLOGARITJA E PRURJEVE

Projektimi i sistemit të kullimit të ujërave është porjektuar duke pasur parasysh prurjet si më poshtë:

- Prurja e UA, në sipërfaqen e sheshit dhe të rampave të hyrjes dhe të daljes nga parking, si dhe të shkallës, së hyrjes dhe daljes së këmbësorëve. Kjo prurje është llogaritur me metodën racionale:

$$Q = \frac{C \times I \times A}{360} \quad [m^3/sec]$$

ku:

Q – prurja e ujërave të reshjeve atmosferike [m³/sec]

C – koeficienti i rrjedhjes sipërfaqësore, i cili është pranuar C = 0.95, meqenëse sipërfaqja konsiderohet e papërshkueshme.

I – intensiteti i rënies së shirave, i cili është marrë nga Buletini i Institutit Hidrometeorologjik, 1985, dhe është pranuar për T = 100 vjet, t = 10 minuta me vlerë i=194 mm/orë.

- Prurja nga sistemi i shuarjes së zjarrit, i cili do të jetë me sprinklera dhe me hidrante. Prurja e dhënë nga projekti i sistemit MNZ, rezulton q = 1000 l/min = 17 l/sek, për secilin kat të parkingut. Pra gjithsej 2000 l/min = 33 – 34 l/sek.

2.2.2. LLOGARITJA E PËRMASAVE TË ELEMENTËVE TË SISTEMIT

Llogaritjet hidraulike janë kryer për përmasimin e elementëve të sistemit, si piletat, kapaciteti i kapakëve të pusëve dhe tubacionet e linjave të kullimit të parkingut.

Llogaritjet për kapacitetin kullues të piletave dhe të kapakëve të pusëve janë kryer duke u bazuar në metodat dhe formulat e HEC no. 22, 3-rd edition of **FHWA** (Federal Highway Administration) – Urban Drainage Manual, dhe HDS no. 4 of **FHWA** – Introduction to Highway Hydraulics. Bazuar në materialet dhe rekomandimet e dhëna nga literaturat e mësipërme, rezulton se kapaciteti i piletave (300 x 300 mm) është $q_G = 6 - 8$ l/sek, kurse kapaciteti kullues i kapakëve tip zgarë të pusëve (400 x 400 mm) është $q_{GR} = 15$ l/sek.

Llogaritjet hidraulike të përmasimit të tubacioneve të linjave janë kryer me formulën Chezy, duke përdorur koeficientin e ashpërsisë sipas Gauckler-Strickler, duke pranuar shkallën e mbushjes së tubacioneve ($h/D = 0.75$). Formula jepet si më poshtë:

$$v = C \times \sqrt{R \times i} \quad [m/sek]$$

ku:

v – shpejtësia e ujit [m/sek];

C – Koeficienti Chezy, i llogaritur si funksion i koeficientit të ashpërsisë Gauckler-Strickler, i cili është pranuar të jetë $80 \text{ m}^{1/3}/\text{sek}$, për tubacionet PE dhe $70 \text{ m}^{1/3}/\text{sek}$, për tubacionet e gizës sferoidale;

i – pjerrësia gjatësore e tubacionit apo kanalit;

Përmasat e tubacioneve sipas llogaritjeve jepen në tabelën e mëposhtme:

Tubacionet prej gize sferoidale		
Diametri Nominal DN [mm]	Diametri i jashtëm Dj [mm]	Diametri i brendshëm Db [mm]
125	137	121.87
150	162	146.25
200	212	195
Tubacionet prej HDPE me dy shtresa (shtresa e jashtme e brinjuar) SN8		
Diametri Nominal DN/OD [mm]	Trashësia e tubacionit S [mm]	Diametri i brendshëm Db [mm]
160	11.5	137
200	14	172
250	16	218
315	21.5	272

- Tubacioni i dërgimit është llogaritur të jetë Tub PE100 Dj 90 mm PFA 10 bar, për të përcjellë prurjen $q = 20$ l/sek.

D.Punime Elektrike

PERMBAJTJA

Hyrje

Të dhënat në lidhje me shpërndarjen e energjisë dhe shfrytëzimit

1. Furnizimi me Energji Elektrike
2. Shperndarja e Energjise
3. Instalimet Elektrike.
4. Sistemi i Ndricimit
5. Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri
6. Sistemi i Detektimit te Gazrave CO dhe NO₂
7. Sistemi i Njoftimit se Publikut
8. Sistemi CCTV
9. Sistemi i Drejtimit te Automjeteve



Hyrje

Projekti elektrik parashikon furnizimin me energji dhe zgjidhjet për sistemet në Parkingun Publik në Sheshin Italia. Llogaritjet janë bërë duke u bazuar në fuqitë e pajisieve mekanike të dhëna nga projektuesi Mekanik si dhe në ngarkesat e tjera për ambientet teknike ,të shërbimit, koridore etj.

Të dhënat në lidhje me shpërndarjen e energjisë dhe shfrytëzimit:

Sistemi i Tokëzimit:

- Sistemi TNS

Tensioni nominal Punës (U_e) :

- 400 V (F/F)
- 230 V (F/N)

Tensioni nominal Izolimit (U_i)

- ≥ 690 V

Tensioni nominal i impulseve (U_{imp}) që durojnë pajisjet e tensionit të ulët :

- 24 kV

Tensioni testues i pajisjeve të tensionit të ulët:

- 1 min. 50 Hz 3500 V

Frekuenca :

- 50 Hz

Shërbimi nominal :

- I pandërprerë

Rënia e tensionit midis burimit dhe ngarkesës

- Maksimumi 4 % në AC (nga klemat e daljes së transformatorit te priza më e gjatë)

Madhësia e kabllit të neutrit :


- sipas kodeve dhe standarteve
- Sa $\frac{1}{2}$ e seksionit të fazës për seksione më të mëdha se 16mm².
- në seksion të njëjtë me atë të fazës në rast furnizimi të pajisjeve që shkaktojnë harmonika (PC, servera, motora).

Kapaciteti i çkycjes dhe durimi i lidhjes së shkurtër :

- CEI 947.2 P1 (cikël 0 – 3 min. – CO)
- $I_{cu} \geq 16$ kA Paneli Kryesor
- $I_{cu} \geq 10$ kA Panelet Shpërndarëse

Kufizimet e Zhurmës:

- Në perputhje me ligjet dhe normat lokale



1. Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike do të realizohet nga linja e tensionit të mesëm 20kV në pikën më të afërt sipas përcaktimit të operatorit të shpërndarjes së energjisë.

Hyrja në objekt do të realizohet me kabëll të tensionit të mesëm me izolacion XLPE me tension izolimi 18/30kV me seksion në perputhje me standartet dhe llogaritjet të fuqisë.

Kabina elektrike do të jetë e pozicionuar në katin -1 të objektit. Celat e TM do të jenë të vendosura ngjitur me dhomën e TR. Hyrja në objekt e linjës së TM do të jetë në celën seksionuese IM dhe në një cele tjetër seksionuese IM do të realizohet dalja për në rrjetin unazor të shpërndarjes. Lidhja me pështjellen primare të TR do të realizohet me ane të një cele QM seksionuese e pajisur me siguresë.

Panelet e shpërndarjes janë vendosur në çdo ambient të nevojshëm sipas projekteve elektrike.

Konsumi energjise matet në tension të ulët. Konsumi total i energjisë është vendosur të bëhet në panelin e tensionit të ulët.

Për shkak të rëndësisë së sistemeve të instalura në Parking që kanë të bëjnë me ruajtjen e jetes së njerëzve është parashikuar instalimi i një gjeneratori momentalisht apo në të ardhmen që do të mbulojë 100% ngarkesën elektrike. Pozicioni i gjeneratorit do shikohet të bëhet në varësi të hapësirave teknike.

Në rast të ndërprerjes së energjisë njësia duhet të fillojë në mënyrë automatike. Nëse kemi mungesë tensioni nga rrjeti, duhet të ndizet gjeneratori duke hapur automatet e rrjetit dhe seksionuesin.

Nëpërmjet njërive të kontrollit sistemi duhet të japi energji në Parking për më pak se 20 sekonda, duke i dhënë ngarkesë sistemeve. Pas kthimit të energjisë nga rrjeti, duhet të paktën të jetë në punë minimumi 30 sekonda, përpara ndëzjes së pajisjeve kryesore përsëri. Gjeneratorët do të ndizen/fiken sipas nivelit të tensionit në furnizimin me rrjet, renditjes së fazave dhe mungesë faze.

Për ngarkesat për të cilat energjia duhet të jetë e pandërprerë parashikohet furnizimi me një UPS të vendosur në dhomën e panelit kryesor. UPS do ketë by-pass automatik për kyçjen dhe çkyçjen në rrjet si dhe një by-pass manual sigurie të parashikuar në panel. Fuqia e Transformatorit, gjeneratorit dhe UPS nxirret në bazë të llogaritjes së ngarkesës dhe paraqiten në projekt.

Transformatori të parashikohet me tre peshtjella 20/6/0.4kV për të qenë sa më fleksibël me lidhjen me sistemin e tensionit të mesëm. Duke pasur parasysh tensionin e furnizimit të nënstacioneve dhe linjave në afërsi të objektit dhe mundësitë e ndryshimit të sistemit në të ardhmen.

2. Shpërndarja e energjisë

Për pajisjet e energjisë të tensionit të ulët nga transformatori në panelin kryesor të shpërndarjes duhet të instalohet me kabllot e përcaktuar dhe llogaritur në varësi të ngarkesës së tij.

Shpërndarja e energjisë elektrike në Parking do të bëhet me përcjellësa bakri. Rryma nominale do të jetë sipas madhësisë së panelit të treguar në skemat e paneleve elektrike në përputhje me ngarkesën elektrike të katit. Instalimi i përcjellësave do të bëhet në kollonat elektrike në ngjitjet vertikale dhe në instalimet me tub fleksibel PVC brenda betonit.

Karakteristikat teknike për panelin kryesor:

- Izolimi tensionit (në përputhje me pajisien) V 1000
- Tensioni punës V 380/400
- Rryma në qark të shkurtër kA 36
- Frekuenca Hz 50/60
- Tensioni ndihmës V 230
- Sistem neutral
- Blindozebarrat (3F ose 3F+N) 3F+N
- Materiali panelit P, G Kromuar
- Fortësia mekanike sipas normës CEI EN 50102
- Lloji panelit Prisma P IP31 me derë transparente IK08
- Ngjyra e jashtme sipas RAL9001
- Ngjyra e brendshme sipas RAL9001
- Shkalla e jashtme mbrojtjes IP31
- Shkalla e brendshme mbrojtjes IP20

3. Instalimet Elektrike

Përcjellësat dhe Kabllot:

Përcjellësat dhe Kabllot duhet të kenë kërkesa të larta për tipin e izolimit, mbështjelljes, dhe përcjellësve të specifikuar.

Kabllot e ushqimit të tensionit të ulët për sistemin e shpërndarjes 400/230V duhet të jenë konform me sistemet EN dhe TNC-S. Tipi izolimit duhet të jetë rezistent ndaj lagështirës dhe nxehtësisë, i përshtatshëm për temperaturë pune maksimale deri në 70 gradë celcius. Kabllot duhet të jenë një copë pa lidhje mes tyre përveç rasteve kur distancat janë më të mëdha se gjatësia maksimale e kabllit.

Kthesat (përkuljet) e kabllave nuk duhet të jenë më pak sesa ato të specifikuara nga prodhuesi për tipin e kabllit të specifikuar.

Të gjithë përcjellësit duhet të jenë prej bakri. Ato duhet të jenë të plotë siç kërkohen.

Induksionet minimale të përcjellësve: të gjitha prizat: 2.5mm²/ instalimet e brendshme të ndriçimit 1.5mm², 400V/230V, Kodi me ngjyra:

- Faze: E zeze, gri, kafe (kabllot)
- Faze: E zeze (telat)
- Neutri: Blu e lehte
- Tokëzimi mbrojtës: Verdhe/jeshile (shirita)

Standartet:

CEI 60 502 : Kabllo fuqie të izoluar me dielektrike të plotë për tensione nominale nga 1kV deri në 30kV..

CEI 60 227 : Përcjellës dhe kablllo të izoluar PVC për rryma nominale deri në 450/750V

Tubat, kutitë dhe Kanalinat:

Brenda parkingut do të jenë të gjitha kabllo të shtrirë në tuba fleksibël. Shpërndarja kryesore e përcjellësave do të bëhet në kanalina metalike sipas seksioneve të dhëna në projekt. Do të përdoren tuba të ndarë për kabllo të fuqisë, të rrymave të dobëta dhe sistemeve të sigurisë të cilat nuk duhet të perziehen me njeri tjetrin. Te gjithë kabllo duhet të fiksohen me kapse kabllosh dhe gjatë fiksimit të tyre të tregohet kujdes ndaj prishjes apo dëmtimit të izolacionit të kabllit që mund të çojë në kontakt direkt të personave me rrymën elektrike.

Konform normave ndërkombëtare IEC 61537.

4. Sistemi i Ndrëçimit

Konfigurimi i ndrëçimit duhet të jetë sipas normës EN 12464: "Ndrëçimi për parkimet publike nëntokë" nën shqyrtimin e kriterëve të cilësisë së përgjithshme për ndrëçim . Llogaritja e ndrëçimit është bërë përmes programeve të simulimit DIALUX.

Nivelet e ndrëçimit mesatare për zonën janë konsideruar si më poshtë :

- Rampat e hyrjes dhe daljes : 300 lux
- Shkallët : 150 lux
- Dhoma inxhinierike dhe dhoma kontrollit: 200 lux
- Zona zyrave dhe ambientet perkatese : 300 lux
- Tualetet : 200 lux
- Parking : 75 lux

Për ridimensionimin e sistemit të ndrëçimit supozimet duhet të referohen EN 12464.

Furnizimi i ndrëçimit do të bëhet nëpërmjet qarqeve kryesore dhe gjenerator.

Ndarja e ngarkesës do të bëhet nëpërmjet qarqeve të veçanta. Kontrolli i ndrëçimit duhet të jetë që në rastin e një alarmi zjarri të gjithë ndrëçimi të jete i ndezur.

Zonat si dhoma e paneleve etj, duhet të jenë të pajisura me ndrëçimin lokal. çdo grup mund të kontrollohet manualisht nga celësa ose pulsant të vendosur në çdo zonë ose të centralizuar.

Gjithashtu në sistemin e ndrëçimit janë parashikuar daljet sinjalizuese normale dhe daljet e emergjencës.

5. Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri

Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit duhet të jetë në përputhje me kërkesat e standartit EN 54-13, standarte vendase ose standarte të tjera ekuivalente.

Sistemi duhet të kryejë këto funksione: Detektimin automatik të zjarrit, procesimin e informacioneve të marra nga sensorët, sinjalizimin, dhënie alarmi në mënyrë manuale dhe detektim i shpejtë i defekteve të vetë sistemit.

Sistemi i parashikuar në projekt është i adresueshëm.

Në zonën e parkimit do të instalohen sensor temperature, të cilët duhet të vendosen me norme në ambientet ku mund të ketë tym dhe gazra të cilët shkaktojnë hapjen e panevojshme të sensorëve të tymit. Pozicioni i sensorve vendoset në bazë të të dhënave të marra nga prodhuesi. Në të gjitha ambientet e tjera instalohen sensor tymi. Pikat e thirrjes manuale duhet të jenë të shpërndara që të plotesojnë kushtin që distanca maksimale për ti arritur nuk duhet të kalojë 45m. Alarmet zanor duhet të vendosen në pozicione dhe mënyrë të tillë që të arrihet niveli i kerkuar i tingullit i cili duhet të jetë 65dB ose të paktën 5 dB mbi nivelin e tingullit të ambientit. Tingulli sduhet të kalojë nivelin maksimal 120dB.

Vendosja e Centralit të zjarrit dhe skema e lidhjes është dhënë në projekt. Me sistemin e zjarrit lidhen : dyert e emergjencës, sistemi i ventilimit dhe ashensori.

Testime duhet të realizohen që të sigurohet që secili nga elementët e realizon në mënyrë korrekte funksionin e tij në të gjitha situatat e pritshme operationale.

6. Sistemi i Detektimit të gazrave CO dhe NO₂

Gazrat CO dhe NO₂, janë komponentet më toksikë të mbetjeve të djegura të karburantit të makinave, situatë që i bën shqetësues për sigurinë në strukturat e parkimeve. Prandaj duhet të merren masa për parandalimin e arritjes së niveleve të patolerueshme të këtyre gazrave. Instalohet një sistem detektimi automatik i këtyre gazrave në parkim i cili bashkëpunon me sistemin e ventilimit për ti mbajtur këto gazra brenda normave të lejuara.

Do të perdoret një central me 4 zona secila me maksimumin 16 sensor për zonë. Sensoret do montohen në kolona të paktën 1.5m mbi dysheme. Cdo sensor mbulon mesatarisht një sipërfaqe prej 700m², një rreth me rreze 15m. Centrali duhet të ketë dalje për kontrollin e sistemit të ventilimit, e cila mund të jetë me një ose dy shpejtesi në varësi të standartit. Niveli i pranueshem i gazrave NO₂ dhe CO i programueshem.

Vendosja dhe skema e lidhjes është e dhënë në projekt.

7. Sistemi i evakuimit zanor

Sistemi i njoftimit te publikut është sistem alarmi zanor ku duhen integruar të gjitha funksionet të parashikuara në perputhje me normat: IEC60849, NEN2575, BS5839/8 dhe EN54-16.

Do të montohen autoparlante në mur me fuqi 10W në zonën e parkimit dhe 6W në ambientet e tjera. Do ketë të paktën dy zona të vecanta thirrjeje.

Autoparlanetet duhet të lidhen nëpërmjet amplifikatorëve të fuqisë të përshtatshëm me kontrolluesin e alarmit zanor dhe player-in e kombinuar DVD/CD.

Pajisjet kryesore të fuqisë të sistemit të autoparlanteve siç janë amplifikatorët, kontrolluesi i alarmit zanor dhe palyer-i/tuner-i i kombinuar DVD/CD duhet të instalohet në rack.

Skema e sistemit dhe vendodhja e elementëve të sistemit është përcaktuar në projekt. Sistemi përbëhet: nga kontrolleri i alarmit zanor, amplifikatori, stacion i njoftimit, altoparlant te ndryshëm, DVD/CD player.

8. Sistemi CCTV

Projekti parashikon instalimin e sistemit të monitorimit CCTV në të gjithë godinën për arsye sigurie. Detyrat e sistemit përfshijnë: monitorimin e korridoreve dalëse dhe parkimit, pozicioni i kamerës dhe specifikimi i lentes për një minimum $\frac{1}{2}$ e monitorimit të lartësisë mesatare të personit në distancë maksimale, kamera IP të brendshme me ngjyra dhe me përdorim për nivelë te uleta ndriçimi, monitorim nga një stacion qëndror. Sistemi CCTV përbëhet nga kamera fikse të insaluara tek hyrjet/daljet e parkimit dhe në pjesën e parkimit për të monitoruar pjesën e lëvizjes së makinave për të siguruar cilësi të lartë mbikqyrjeje. Parkimi do të ketë grupin e kamerave dhe pajisjeve CCTV të vendosura në Rack-un kryesor. Të gjitha kamerat do të lidhen me kabëll Cat.6 sipas vizatimit nga pajisjet kryesore të vendosura në katin -1 për çdo kamere. Qellimi i sistemit te monitorimit me kamera është monitorimi i trafikut dhe i hyrje daljeve të Parkingut.

Sistemi përmban:

- Kamera IP, fikse, me ngjyra
- NVR për manaxhimin dhe regjistrimin e videove

Të gjitha paisjet e sistemit që ndodhen në rack do të furnizohen me energji të pandërprerë nga UPS. Pajisjet do të jene të përshtatshme për montim në rack. Video/Monitorimi do të lidhet me dhomën e monitorimit në parkim duke përdorur një fiber 4-8 –fijesh.

9. Sistemi i drejtimit te automjeteve

Sistemi i drejtimit të automjeteve përfshin: barrierat e hyrjes dhe të daljes, kasat e pagimit, sensorët e sigurisë, sensorët ultrasonik të numërimit të automjeteve në hyrje dalje dhe në rampë, sensorët e detektimit dhe tregues të vendeve të parkimit, tabelë treguese në hyrje që përcakton numrin e vendeve të lira të parkimit për 2 nivelet.

Qëllimi i sistemit të drejtimit të automjeteve është lehtësimi i lëvizjes dhe praktikiteti i përdorimit të parkingut në bazë të informacioneve dhe sinjalistikave të dhena nga sistemi.

Modulet e kontrollit zonal dhe modulet e numërimit vendosen në server room. Parkimi është ndarë me 4 zona të kontrolluara me nga një kontrollor zonal i aftë të lidhet me deri në 96 sensore parkimi me tre loop-e. Skema e lidhjes dhe pozicionet jepen në projekt.

Modulet të çertifikuara dhe në përputhje me standartet: IEC 60905-1 :2005 (Botimi i dyte), EN 60950-1 :2006 (Botimi i dyte) + A1 1 :2009, UL60950-1 , CAN/CSA22.2 Nr. 60950-1 -07.

Barrierat e makinave automatike dhe lexuesit e kartës do të jenë të pozicionuar në hyrje dhe në dalje. Lexuesit e kartës do të jenë pjesë e kontrollit të sistemit të hyrjes. Përveç lexuesit të kartës në hyrje do të jetë e mundur që barrierat të ketë një hapje manuale nga dhoma e monitorimit. Loop-et e sigurisë do të jenë të mundura në të gjitha barrierat.



E.Punime MNZSH

1.1 PËRMBAJTJA E RELACIONIT TEKNIK MNZSH-SË

Ky Relacion Teknik i projektit “Dokumentacioni Grafik për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin” i objektit “Parkimi nëntokesor të sheshi Italia, Tirane përmban:

- 1- Pjesën e relacionit të projektit të arkitekturës urbane;
- 2- Pjesën e relacionit të projektit konstruktiv të MNZSH-se;
- 3- Pjesën e relacionit të projektit mekanik të MNZSH-se;
- 4- Pjesën e relacionit të projektit elektrik të MNZSH-se;
- 5- Pjesën e relacionit të projektit hidrik të MNZSH-se;
- 6- Pjesën e relacionit për skemat e vakuimit.

1.2 MBESHTETJA LIGJORE DHE NORMATIVE

Projekti për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin i objektit “Parkimi nëntokesor të sheshi Italia në Tirane është realizuar në baze të standarteve dhe normave lokale si dhe ato të vendeve të Komunitetit Europian. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit respekton të gjitha kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat / standartet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri si dhe normat Europiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standartet e përdorura në këtë projekt janë paraqitur në vijim:

- Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Rregullore “Mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji “Vendim nr.162 datë 19.4.1965, e ripunuar;
- Udhëzim i Ministrisë të Punëve të Brendshme nr.425 datë 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe leshimin e akteve teknike”;
- Urdhër nr.45 datë 09.04.2004 “Mbi rruajtjen e vlerave materiale nga zjarri në depo dhe magazina”.
- EN 13501 Fire classifications of construction products and building elements (all parts)
- IEC 79-10 Area Classification Guidelines
- EN 2 Classification of fires
- EN 1838 Lighting applications – Emergency lighting
- EN 1366 Fire resistance tests for service installations
- NFPA 10: Standard for Portable Fire Extinguishers, 2010 edition.
- BS EN B2: Fire Safety – Buildings other than Dwelling houses – Volume 2

1.3 PJESË E RELACIONIT TË PROJEKTIT ARKITEKTUROR

Objekti "Parkimi nëntokësor te sheshi Italia në Tiranë" përbëhet nga 2 kate parkimi nëntokë. Sipërfaqja totale e çdo kati parkim nëntokë është 3.587m². Vetë sipërfaqja e parkimit në çdo kat është 2915m² dhe diferenca përbëhet nga ambiente teknike, depozitat e ujit të impjantit të mbrojtjes nga zjarri dhe ambientet sanitare. Parkimi ndodhet në zonë urbane dhe ka akses të drejtpërdrejtë në rampat hyrëse dhe dalëse të tij për në parkim. Edhe në brendësi të ndërtesës forcat zjarrfikëse dhe të shpëtimit i kanë hapsirat e duhura për të kryer me efektivitet veprimet operacionale në zgjidhje të situatave.

Parkimi klasifikohet nëntokësor dhe i mbyllur duke qenë se ndonëse parashikohen hapjet perimetrale për ventilimin natyral në kushte normale të funksionimit, këto hapje janë më të vogla se 60% e sipërfaqes së mureve anësore dhe më të vogla se 4% të sipërfaqes së parkimit.

1.3.1 KOMPARTIMENTIZIMI

Duke qenë se parkimi është i mbyllur sipërfaqja maksimale për një kompartiment zjarri është 2500m², e cila dyfishohet me përdorimin e një impjanti të shuarjes automatike të zjarrit. Duke qenë se parashikohet në projektin hidrik të mbrojtjes nga zjarri një impiant "sprinkler" sipërfaqja maksimale e një kompartimenti shkon në 5000m². Për këtë arsye parkimi çdo kat parkim përbën një kompartiment zjarri, pa qenë nevoja e ndarjeve të mëtejshme.

1.3.2 LARTËSITË E KATEVE PARKIM

Lartësitë e kateve janë përkatësisht 3.2m për katin -1 dhe 2.56m për katin -2 dhe struktura e soletave për të dyja katet është parashikuar monolite pa trarë të varur.

1.3.3 NUMRI I POSTEVE TË PARKIMIT

Numri i vendeve të parkimi në katin -1 është 92+2 poste ndërsa në katin -2 janë parashikuar 104 poste parkimi automjesh.

1.3.5 VENTILIMI I PARKIMIT NËNTOKËSOR

1.3.5.1 Ventilimi natyral

Ventilimi natyral ka për qëllim që të garantojë parametrat të pranueshëm të cilësisë së ajrit për mosdëmtimin e shëndetit të përdoruesve të parkimit. Parkimi është i projektuar në mënyrë që

të sigurohet ventilimi natyral i tij duke garantuar një sipërfaqe ventilimi për çdo kat parkim (kompartiment) jo më të vogël se 1/25 e sipërfaqes së tij (4% e sipërfaqes së parkimit).

Në këtë mënyrë, për të dy katet:

- sipërfaqja: 2915m²;
- sipërfaqja e nevojshme e ajrimit natyral: 117m²;

Parkimi është i projektuar në mënyrë që të sigurohet një sipërfaqe ventilimi natyral i tij për katin e parë nëntokë prej rreth 98m² (3.3% 3 sipërfaqes së parkimit dhe për katin e dytë nëntokë prej rreth 58m² (2% e sipërfaqes së parkimit).

Për këtë arsye, ventilimi natyral shoqërohet dhe një sistem i ventilimit mekanik.

1.3.5.2 Ventilimi mekanik

Ndonëse numri i posteve të automjeteve në parkim është më i vogël se ai i kërkuar nga normativat që kërkojnë integrimin e ventilimit natyral me atë mekanik (<125 autovetura në katin-1 dhe <100 autovetura në katin-2) në projektin e parkimit sheshi "Italia", sistemi i ventilimit natyral është kombinuar me sistemin e ventilimit mekanik i cili parashikon largimin e tymit në rast zjarri; sasia e ajrit të larguar nga sistemi mekanik është marë 10 vëllime në orë.

Në këtë mënyrë për katin -1 parashikohen pajisje të largimit të ajrit me kapacitet 2915m² x 3.2m 3ach = 93.000m³/orë dhe per katin -2 me kapacitet 2915m² x 2.56m x 10 ach = 75.000m³/orë.

